



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

M. 020/04-12486/23, me 18 JAN 2023

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta zyrtare e Kosovës nr.28/2008, të nenit 20 të Rregullores nr.22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimin në pajtim me Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë 2018/2022, si dhe shkresës zyrtare nr.02/572/1 dt.28.05.2019, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.Nr.110-391 dt.25.02.2010, Kryetari i Komunës merr këtë :

**V E N D I M**

**PER FORMIMIN E GRUPIT PUNES PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNEN E PRISHTINËS 2023-2025.**

I. Formohet Grupi Punës për hartimin e Planit të Veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Prishtinës.

- 1.Betim Abdullahu , Kryesues,
- 2.Klaudia Mula , Zyrtare për Kthim dhe Komunitete,
- 3.Munavere Qerkezi , Drejtorja e Mirëqenies Sociale,
- 4.Jehona Krasniqi, Burime Njerëzore,
- 5.Premtime Preniqi , Drejta të njeriut,
- 6.Ajshe Berveniku, Integrimi Evropiane,
- 7.Shkendije Krasniqi, Ofiqari,
- 8.Albana Binaku, Financa,
- 9.Mevludë Zejnullahu, Shërbime Publike,
- 10.Sokol Gashi, Drejtorja e Pronës,
- 11.Mevlan Hyseni, Qendra për pune sociale,
- 12.Besim Zogaj, Zyra e punësimit,
- 13.Sllavica Stoliç, Zyrtare për kthim,
- 14.Nexhmi Demolli, Drejtorja e Kadastrit,
- 15.Vjollca Rexhepi-Morina, Zyra Ligjore .

II. Grupi punës nga pika I e këtij Vendimi ka për detyrë të hartojë Planin e Veprimit Lokal për ri integrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve ,bazuar në obligimet dhe përgjegjësit që i takojnë secilës drejtori , veçmas Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe Qendrës për Punë Sociale.

- III. Bazuar në Planin e Veprimit Lokal për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ri integrimin e Personave të riatdhesuar dhe Rregulloren 22/2020, për ri integrimin e personave të riatdhesuar, komuna përkatëse është përgjegjëse për sigurimin e banimit, bonusit të banimit të përshtatshëm për personat e riatdhesuar. Kjo parashihet duke u bazuar edhe në ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për financimin e programeve të veçanta të banimit, qe komuna është përgjegjëse për të siguruar banimin për qytetaret e saj në nevojë .
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**I DOREZOHET :**

- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
- Anëtareve të Komisionit ,
- Qendrës për shërbim me qytetarë,
- Në dosje.

